



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 944/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të mbajtur më 30.06.2022 dhe 102-të mbajtur më 14.07.2022 mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
  1. *Edukimi Muzikor, MA* 60 ECTS, maksimumi 5 studentë për vit akademik;
- II. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
  2. *Teknologji e Prodhimit Bimor, BSc* 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
  3. *Menaxhim në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis, BSc* 180 ECTS me specializim: 1. *Menaxhimi në Turizëm*, 2. *Menaxhimi në Hotelieri*, 3. *Menaxhimi në Mjedis*, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
  4. *Menaxhment u Turizam, BSc* 180 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik;
  5. *Edukimi Artistik në Interpretim, BA* 240 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik;
  6. *E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane, LLM* 60 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik;
  7. *Agromjedis dhe Agroekologji, BSc* 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
  8. *Menaxhim Biznesi, MSc* 120 ECTS, me specializim: 1 *Kontabilitet dhe Auditim*, 2. *Banka dhe Financa*, 3. *Administrim Biznesi*; maksimumi 120 studentë për vit akademik në gjuhën shqipe dhe maksimumi 30 studentë për vit akademik në gjuhën boshnjake;
- III. Nuk akreditohet programi i studimit:
  9. *Juridik i Përgjithshëm LLB* 240 ECTS;
- IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.

- VII. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VIII. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Universiteti “Haxhi Zeka” në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	<i>Edukimi Muzikor, MA 60 ECTS</i> Riakreditim	Hysen Nimani
2.	<i>Teknologji e Prodhimit Bimor, BSc 180 ECTS</i> Riakreditim	Ismajl Cacaj Nazmi Hasanaj Defrime Berisha
3	<i>Menaxhim në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis, BSc 180 ECTS me specializim;</i> <i>1. Menaxhimi në Turizëm,</i> <i>2. Menaxhimi në Hotelieri,</i> <i>3. Menaxhimi në Mjedis,</i> Riakreditim	Bedri Millaku Bekë Kuqi Adem Dreshaj Behrije Ramaj Thëllëza (Latifi) Sadrija Enkeleda Lulaj
4	<i>Menadzment u Turizam, BSc 180 ECTS</i> Riakreditim	Anela Džogović Hajrija Škrijelj Merita Begolli Dauti
5	<i>Edukimi Artistik në Interpretim, BA 240 ECTS</i> Riakreditim	Mimoza Drançolli Dardane Nallbani Besa Berberi Fatbardh Gashi
6	<i>E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane, LLM 60 ECTS</i> Riakreditim	Gjylbehare Murati
7	<i>Juridik i Përgjithshëm LLB 240 ECTS</i> Riakreditim	Avdullah Robaj Sabiha Shala Kolë Krasniqi Ardrit Gashi Petrit Nimani
8	<i>Agromjedis dhe Agroekologji, BSc 180 ECTS</i>	Naser Bajraktari Milaim Musliu Gjok Duhanaj

9	<i>Menaxhim Biznesi, MSc 120 ECTS, me specializim:</i> <i>1 Kontabilitet dhe Auditim,</i> <i>2. Banka dhe Financa,</i> <i>3. Administrim Biznesi;</i>	Vlora Berisha Fisnik Morina Bedri Statovci Florin Peci Baki Koleci Emin Neziraj
---	--	--

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë me këtë përbërje: Reiner Doluschitz, Jadranka Pelikan, Olgun Cicek, Rebecca Maxwell, Giga Khositashvili, Marina Novak, Mërtiç Upmacis, Stephen Shute, Johan Falterbaum, Katerina Klimoska, Dietmar Paier, Delia Gologan dhe Marko Komso. Vizitat janë organizuar në datat 22.03.2022, 15.04.2022, 13.05.2022 14.06.2022 dhe 16.06.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Edukimi Muzikor, MA 60 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) standarde, substancialisht katër (4) standarde dhe pjesërisht një (1) standard.
2. Për programin e studimit *Teknologji e Prodhimit Bimor, BSc 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1) standard dhe substancialisht gjashtë (6) standarde.
3. Për programin e studimit *Menaxhim në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis, BSc 180 ECTS me specializim: 1. Menaxhimi në Turizëm, 2. Menaxhimi në Hotelieri, 3. Menaxhimi në Mjedis*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht tri (3) standarde dhe substancialisht katër (4) standarde.
4. Për programin e studimit *Menadzment u Turizam, BSc 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht tre (3) standarde dhe substancialisht katër (4) standarde.
5. Për programin e studimit *Edukimi Artistik në Interpretim, BA 240 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) standarde, substancialisht tre (3) dhe pjesërisht dy (2) standarde.
6. Për programin e studimit *E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane, LLM 60 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht pesë (5) standarde, substancialisht një (1) dhe pjesërisht një (1) standard.
7. Për programin e studimit *Juridik i Përgjithshëm LLB 240 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht tre (3) standarde, pjesërisht dy (2) standarde dhe nuk i plotëson dy (2) standarde.
8. Për programin e studimit *Agromjedis dhe Agroekologji, BSc 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht shtatë (7) standarde.
9. Për programin e studimit *Menaxhim Biznesi, MSc 120 ECTS, me specializim: 1 Kontabilitet dhe Auditim, 2. Banka dhe Financa, 3. Administrim Biznesi*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1) standard, substancialisht katër (4) dhe pjesërisht dy (2) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 dhe 102 të mbajtur më 14.07.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Ass. Dr. Hasni Haxhi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

